



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUŽILAČKI SAVET KOSOVA
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA

Pranuar 26 -07- 2023 Primitjeno

Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkrimi i pranuesit Potpis primaoca
1154		



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

MEKANIZMI I RAPORTIMIT TË KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE THEMELORE NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

I. PJESA E PËRGJITHSHME:

UD. Kryeprokurori Enis GASHI		Prokuroria Themelore në GJAKOVË		Muaji: Prill, Maj, Qershor, Viti 2023		Nënshkrimi													
Emri, mbienri Kryeprokurorit		Prokuroria		Periodha raportimit		Nënshkrimi													
Numri i prokurorëve dhe stafit administrativ në prokurori:		ud. Kryeprokurori:		1	Administratori:		1												
		Nr. i prokurorëve në DKR:		2	Bashkëpunëtorë profesional:		8												
		Nr. i prokurorëve në DM:		1	Zyrtar ligjor:		15												
		Nr. i prokurorëve në DP:		10	Stafi tjetër:		18												
		Sqarimi tek II/2 Totali:		14	Totali:		42												
A) Numri i kallëzimeve penale të pranuar:		B) Numri i kallëzimeve penale të proceduara (zgjidhura/kryera):		C) Përqindja e rasteve të proceduara (B%A)		D) Ngarkesa me lëndë													
404		426		105.44 %		1.392 ¹													
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga prokurori:	Aktakuza të ngritura:	Hudhje të kallëzimit penal:		Pushim i hetimeve:		Mënyrë tjetër:													
	330	135 (87 Ndërmjetësim)		32		15 ²													
Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata:	Aktakuza të hudhura:	Aktakuza të Refuzuara		Aktgjykime liruese		Aktgjykimi dënues													
	0	0		1		152													
Ankesa kundër aktgjykimit: 15				Ankesa kundër aktvendimit:															
Të aprovuara		Të refuzuara		Të aprovuara		Të refuzuara													
4		12		0		1													
Arritshmëria e normës orientuese të prokurorëve, për periudhën kohore të raportimit:																			
Departamenti për Krime të Rënda:		37	102.80 %	6 raste në muaj është norma e prokurorit në DKR,															
Departamenti për të Mitur:		38	126.80 %	10 raste në muaj është norma e prokurorit në DM,															
Departamenti i Përgjithshëm:		351	152.60 %	23 raste në muaj është norma e prokurorit në DP,															
Arritshmëria e normës në Prokurori:		426	127.33 %	Mesatarja (3/1) e përqindjes në prokurori															
Performanca e prokurorisë në luftimin e Korrupsionit (Paditë Penale 'PP'). Shëno të dhënat në tabelë:																			
Raste të pranuar:		Raste të kryera:		Ngarkesa me raste:		Hudhje		Pushim		Janë ngritur Aktakuza		Aktakuza hudhura		Aktakuza të refuzuara		Aktgjyqi me liruese		Aktgjykim e dënues	
R ³	P ⁴	R	P	R	P	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona
7	15	22	45	25	52	14	12	16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7

¹ Ngarkesa me lëndë: Gjithsejte lëndë të mbetura nga periudha tetor, nëntor, dhjetor 2022 (me lëndët e trashëguar nga vitet paraprake 1414), rastet e pranuar dhe të zgjidhura në këtë tre mujor, në total ngarkesa me lende në fund të periudhës raportuese është 1.392.

² Mënyra tjera: Delegim në kompetencë dhe kundërvajtje.

Performanca në sekustrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Shëno të dhënat në tabelë:				
Kërkesa të aprovuara për dhënin e urdhrin për sekuestrim të përkohshëm	Kërkesa të aprovuara për konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve financiare	Kërkesa të aprovuara për dhënie të aseteve në shfrytëzim të qeverisë	Kërkesa të aprovuara për dhënie të aseteve në administrim të AAPSK	Kërkesa për kompensimin e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara
(15 kërkesa)	(4 kërkesa)			

II. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

1	<p>Niveli i organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë? Komento: Përkundër rrethanave në periudhën raportuese sikurse edhe me raportet paraprake siç është numri i vogël i prokurorëve për të tri departamentet dhe vështirësive të paraqitura, kemi arritur që të bëjmë menaxhimin, administrimin dhe funksionimin e prokurorisë duke i dhënë prioritet trajtimit të rasteve të cilat kanë qenë të natyrës urgjente dhe me masa për sigurinë e pranisë së palëve në procedurë.</p>
2	<p>Çështjet e avancimit dhe transferimit të prokurorëve? Komento: Duke marr për bazë faktin se në muajin korrik 2022 jam caktuar UD Kryeprokuror dhe në lidhje me këtë pike duhet cekur se edhe në këtë tremujor bazuar në raportet javore, mujore numri i lendeve që pranohen është me i madhe në raport me numrin e lëndëve që përfundohen, në veçanti në DP dhe DM.</p> <p>Në këtë pikë bëjë sqarim se nga gjithsejtë 14 prokuror në PTH Gjakovë, për periudhën raportuese me lëndë me dhe përfaqësime kanë qenë të ngarkuar gjithsejtë 7 prokuror: unë në cilësi të ud. Kryeprokurorit edhe pse me 01.11.2022 një prokuror është avancuar në DM, një pjesë të lëndëve nga ky departament i kam mbajtur në punë dhe ende i kam në trajtim e sipër po ashtu vazhdoi të mbaj kujdestarinë në DM dhe DKR, ndërsa dy prokuror në DKR dhe tre prokuror në DP (një nga këta 3 prokuror, ka qenë i transferuar përkohësisht nga PTH Prizren deri më 31.06.2023), po ashtu nga 01.06.2023 prokurori Kastriot Memaj është ngarkuar me lëndë pasi që deri me këtë datë ka qenë në pritje të dekretit të përhershëm.</p> <p>Duhet cekur fakti se 6 prokuror gjenden në trajnim fillestar në AD, të njëjtit gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë qenë të ngarkuar me lëndë dhe përfaqësime në gjykatë, kështu që për shkak të numrit të vogël të prokurorëve, me gjithë përpjekjet maksimale kemi pasur vështirësi në trajtimin e kallëzimeve penale, procedimin e palëve dhe përfundimin e hetimeve, gjithashtu vështirësi paraqiten edhe në përfaqësimin e rasteve në gjykatë.</p>
3	<p>Çështjet e përgjegjësive disiplinore të prokurorëve apo stafit mbështetës? Komento: Brenda periudhës raportuese nuk ka pasur kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorëve.</p>
4	<p>Çështjet e vlerësimit të punës së prokurorëve përfshirë mospajtimet e prokurorëve? Nivelet e vlerësimit të prokurorëve si dhe tejkalimi kuotës 20% të dalluar? Komento: Në lidhje me këtë pikë është bërë "Vlerësimi vjetor i prokurorëve për vitin 2022, vlerësimet janë dorëzuar Komisionit për vlerësim të performances, prokurorët Ardita Beqiri dhe Deshira Jusaj kanë paraqitur kundërshtim ndaj këtij vlerësimi. Nuk ka pasur vlerësim "i dalluar".</p>
5	<p>Çështjet e rasteve të ndërlikuara dhe vendimet nga Kryeprokurori për njohjen e këtyre rasteve ? Komento: Gjatë periudhës raportuese janë në trajtim e sipër dy raste – vrasje e rëndë.</p>
6	<p>Ankesat ndaj shqiptimit të sanksionit penal të shqiptuar (Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit) ? Komento: Gjatë periudhës raportuese por edhe më herët, prokurorët gjithëherë udhëzohen nga ana e Kryeprokurorit lidhur me ushtrimin e ankesave dhe atë duke cekur ankese në aktgjykim, aty ku vlerësohet, mirëpo aktgjykimet ju dërgohen prokurorëve dhe të njëjtit pas shikimit udhëzohen por edhe vet prokurori vlerëson për ushtrim të mjeteve juridike edhe në rastin kur është vërejtur se është mese e nevojshme dhe njëkohësisht e domosdoshme ushtrimi i ankesave edhe pa udhëzimin e kryeprokurorit.</p>
7	<p>Zbatimi i politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit? Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së prokurorëve mentorë për prokurorët fillestar? Komento: Prokurorët nga të tri departamentet kohë pas kohe kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme, po ashtu personeli i prokurorisë mirëpo tek prokurorët janë shfaqur vështirësi të theksuara për shkak të numrit të vogël të tyre dhe përfaqësimit të lendeve në Gjykatë me degët e saj pasi sipas organizimit aktual të Gjykatës përfaqësime të lendeve kemi 5 (pesë) ditët e javës dhe mundësit e koordinimit për të krijuar hapësirë për trajnim të një prokurori janë të limituara.</p> <p>Sa i përket kriterëve prokurorëve mentor për prokurorët fillestar janë caktuar nga KPK në bashkëpunim me AD, për gjashtë prokurorët të cilët janë duke ndjekur trajnimin fillestar dhe se kriteret janë të caktuara sipas rregullores së KPK-së ku niëri ndër kushtet kryesore është që prokurorët mentor të jenë të kualifikuar dhe të jenë të aftë për të trajnuar prokurorët fillestar.</p>

8	<p>Niveli i zbatimit të Kodit të Etikës profesionale për prokurorë dhe stafin administrativ? Komento: Prokurorët dhe stafi administrativ gjithërë kujdesen që Kodin e Etikës Profesionale të e zbatojnë sipas standardeve të përcaktuara dhe brenda periudhës raportuese nga Prokurorët dhe stafi administrativ nuk kemi vërejtur shkelje të kodit për të vepruar konform dispozitave ligjore.</p>
9	<p>Niveli i pavarësisë së prokurorëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale? Komento: Prokurorët gjithërë veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme në kryerjen e punëve të tyre të përcaktuara me ligj dhe për këtë inkurajohen edhe nga UD. Kryeprokurori në çdo takim në kolegji, me kërkesë që të respektohen dispozitat ligjore, por tani duhet të cekim se gjatë kësaj periudhe raportuese duke marr për bazë faktin se ka hyrë në fuqi Kodi i ri i Procedurës penal, ashtu që në bazë dispozitave të reje, në lidhje me aktvendimet për pushim të hetimeve dhe hudhje të kallëzimeve penale, prokurorët paraprakisht konsultohet me mua në cilësi të UD Kryeprokurorit ku edhe përpilohet një shënim zyrtar.</p>
10	<p>Zbatimi i politikave të KPK dhe ZKPSH, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ? Komento: Prokurorët gjithërë janë në zbatim të politikave të KPK dhe ZKPSH, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, po ashtu zbatimi i politikave ju kërkohet edhe nga UD. Kryeprokurori në secilin kolegji që mbahet me prokuror.</p>
11	<p>Niveli i zbatimit të kërkesave nga Komisionet e Përhershme të Këshillit dhe nga vet KPK-ja? Komento: Prokurorët gjithërë janë të përkushtuar për të zbatuar kërkesat të cilat na arrijnë nga Komisionet e Përhershme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.</p>
12	<p>Performanca e prokurorëve në përdorimin e sistemit SMIL ? Komento: Të gjithë prokurorët kanë aftësi të mira në përdorimin e programit Smil, por sikurse është cekur më lartë për shkak të ngarkesave në përfaqësim të seancave gjyqësore nga prokurorët, ka vështirësi dhe mungesë e kohës për përdorim të programit smil nga prokurorët.</p>
13	<p>Sfidat apo të arriturat: Komento: Edhe gjatë kësaj periudhë raportuese jemi përkushtuar që në vazhdimësi të përballemi me sfidat të cilat na janë paraqitur gjatë punës tonë të përditshme dhe që të kemi rezultate sa më të mira në këtë drejtim, duke marr për bazë mungesë e prokurorëve kështu kemi vështirësi dhe vonës në trajtimin e kallëzimeve penale, procedimin e palëve edhe përfundimin e hetimeve, gjithashtu vështirësi paraqiten edhe në përfaqësimin e rasteve në gjykatë dhe kjo gjendje në prokurorin tonë do të ndryshoi pasi që prokurorët që gjenden në trajnimin fillestar, përfundojnë trajnimin dhe ngarkohen me lëndë.</p>

III. ZBATIMI I OBLIGIMEVE SIPAS PLANIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË SHPETIT

1	<p>Objekti 1: Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale me prioritet. Komento: Në vazhdimësi në kontakt me prokurorët dhe stafin mbështetës, jemi të përkushtuar që në punën e përditshme të rrisim efikasitetin në lëndët me prioritet, rastet me paraburgim, rastet e dhunës në familje, veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, veprat penale kundër integritetit seksual si dhe në rastet në të cilat rrezikohet parashkrimi i tyre.</p>
2	<p>Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit. Komento: Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese si gjithërë si deri me tani jemi përkujdesur që në punën e përditshme të jemi transparent dhe llogaridhënës me publikun, mediat në drejtim të rritjes së besimit të publikut për punën dhe përkushtimin e Prokurorisë Themelore Gjakovë.</p>
3	<p>Objekti 3: Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të asetëve të fituara me vepër penale. Komento: Gjatë periudhës raportuese ka raste sa i përket sekuestrimit- konfiskimit të asetëve të fituara me vepër penale në rastet penale ku ka pasur bazë ligjore për sekuestrim, po ashtu do të insistojmë të zbatojmë ligjin për kompetenca të zgjeruara në të gjitha rastet gjithmonë aty ku ka hapësirë ligjore.</p>
4	<p>Objektivi 4: Zvogëlimi i numrit të lëndëve në Prokurorinë e Shtetit. Komento:---</p>
5	<p>Objektivi 5: Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i vazhdimësisë së punës në pandemi. Komento: --</p>
6	<p>Objektivi 6: Administrimi efikas, llogaridhënia dhe rritja e profesionalizimit: Komento: Edhe në këtë periudhë kohore kemi shtuar kujdes që të arrijmë rezultate të mira në administrimin sa më efikas, llogaridhënie dhe rritjen e profesionalizimit të punës në prokurori.</p>
7	<p>Objektivi 7: Aplikimi më efikas i procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve penale. Komento: Edhe në këtë periudhë raportuese janë aplikuar procedurat alternative në zgjidhjen e rasteve penale, sidomos përmes procedurës alternative- ndërmjetësimit.</p>

8	<p>Objektivi 8: Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i Prokurorit të Shtetit:</p> <p>Komento: Si çdo herë edhe gjatë kësaj periudhe raportuese kemi ofruar ndihmë në zgjidhjen e efikase dha sa me të shpejtë në kërkesat ndërkombëtare të parashtruara nga shtetet tjera ne zgjidhjen e rasteve penale, duke u përkujdesur që në këto kërkesa të veprimet në afatin sa me të shpejtë me të mundshme, dhe me qëllim të koordinimit sa më të mirë të këtij bashkëpunimi, unë në cilësi të UD Kryeprokurorit po ashtu jam i caktuar edhe prokuror koordinator për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, pas pensionimit të prokurorit paraprak dhe i kam në punë dhe i trajtoj të gjitha rastet sipas regjistrit NJN.</p>
---	---

IV. KËRKESAT SPECIFIKE TË KPK-së, (për periudhën e konkrete të shenjzuar të raportimit)

1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	
8	

V. ASPEKTE ADMINISTRATIVE:

Raportimi	Periudha kohore për të cilën raportohet	Shenjzimi
I parë:	Nga 1 janar deri më 31 mars të çdo viti	
I dytë:	Nga 1 prill deri më 30 qershor të çdo viti	X
I tretë:	Nga 1 korrik deri më 30 shtator të çdo viti	
I katërt:	Nga 1 tetor deri më 31 dhjetor të çdo viti	

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kërkuar nga Kryeprokurori që të dorëzoj raportin:	Kryeprokurori e ka dorëzuar raportin në Këshill (para raportimit):
Me datë: 14.08.2023	Me datë: 25.07.2023

Dt. 24.07.2023

PROKURORIA THEMELORE-GJAKOVË

E.G

FLETËDËRGESA PER DORZIM PERSONAL

Këshillit Prokurorial të Kosovës

Z. Jetish Maloku

KPK

në _____

Pasi marrësi nuk u gjet në vendin ku duhej të dorëzohej shkresa, dorzimi u bë duke ju dhënë shkresa anëtarit madhor të familjes së marrësit-kujdestarit të ndërtesës, fqijt, personit që gjendet në punë në të njëjtin vend.

2.Pasi marrësi ose pjesëtari i familjes së tij e ka refuzuar marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke u ngjitur në derën e banesës ose të lokalit kku gjendet në punë marrësi).

Me _____ në orën _____

Shkaku i refuzimit _____

Nënshkrimi i dorëzuesit _____

Titulli i shkresës që dorëzohet

Raport për muajin Prill-Maj-Qershor

Numri i shtojcave _____

Vërtetohet se mora shkresën e lartpërmendur me (me fjalë)

Nënshkrimi i marrësit

2607-2

Nënshkrimi i dorëzuesit

D3curat